



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr.463/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “Joos & Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “Marisa SHPK& Company Murseli” Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe çiklizëm Çabrat-Jahoc”, me nr. të prok: “632-20-1308-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë, më datën: 05.08.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Joos & Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe çiklizëm Çabrat-Jahoc”, me nr. të prok: “632-20-1308-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe çiklizëm Çabrat-Jahoc”, me nr. të prok: “632-20-1308-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Joos & Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “Joos & Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 10.07.2020 me nr.463/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe çiklizëm Çabrat-Jahoc”, me nr. të prok: “632-20-1308-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 2, 7, 24, 51, 56, 59 dhe nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 15.07.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 24.07.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankues në fjalë për OE të rekomanduarin:

Me qasjen tonë në dokumente të GOE të rekomanduar për dhënie të kontratës “Marisa SHPK&Company Murseli” kemi vërejtë se ky konzorcium nuk është i përgjegjshëm, dokumente të cilat i mungojnë konzorciumit në fjalë janë:

- Vërtetimin e ATK-së
- Certifikatën e Gjykatës Ekonomike
- Vërtetimin e Tatimit në Pronë si dhe
- Identifikimi Financiar

Përgjigjja e AK-së për këto pretendime është:

Pretendimi juaj se:

Grupit të operatorëve ekonomik "Marisa" sh.p.k. & "Company Murseli" sh.p.k., ju mungon Vërtetimi i ATK-së. Tatimit në pronë dhe Gjykatës, nuk qëndron, sepse sepse të gjitha këto i kanë dorëzuar kopje fizike me dt.23.06.2020, kurse identifikimi financiar iu kërkohej kontraktuesin ta sjell kur të vjen për nënshkrim të kontratës;

Eksperti Shqyrtues që të jetë sa më objektiv, ka kërkuar sqarim me e-mail me 23.07.2020 tek AK për përgjigjen e dhënë më lartë, dhe i njëjti më datë 24.07.2020 na ka dërguar me e-mail (Vërtetimin tatimor të ATK-së, Certifikatat e Gjykatës e Ekonomike si dhe Vërtetimin e Tatimit në Pronë[shih të bashkangjitura mbrapa Ekspertizës])

Eksperti Shqyrtues këto pretendime i gjene të pa bazuara, me arsyen se OE i rekomanduar i ka dërguar kopjet fizike në afatin e caktuar tek AK.

Pretendimi tjetër i OE ankuesit për OE të rekomanduarin:

- Sigurimi i tenderit Gabim, ku e dimë se tek RRUOPP thuhet se nëse "Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesa e DT"-Refuzo tenderin pa kërkuar informacione të mëtutjeshme" 57.

Përgjigjja e AK-së për këtë pretendim është:

Pretendimi juaj se:

Grupit të operatorëve ekonomik "Marisa" sh.p.k. & "Company Murseli" sh.p.k., ka pasur sigurimin e gabuar dhe për këtë arsye duhet të eliminohet, nuk qëndron, sepse ne kemi pyetur përmes telefonit në KRPP-ë dhe sipas tyre, mundemi që përmes nenit 72 të LPP-së, ta kërkojmë sigurimin me të njëjten datë(05.05.2020), sepse nëse arrin të na prezantoj, atëherë do të thotë se vërtetë ka qenë gabim teknik. Me dt.17.06.2020, është kërkuar nga Grupit të operatorëve ekonomik "Marisa" sh.p.k. & "Company Murseli" sh.p.k, që të sjellë sigurimin dhe me dt 18.06.2020, i njëjti ka sjellë sigurimin të bërë me dt.05.05.2020;

Eksperti Shqyrtues gjithashtu në e-mailin e dërguar me 23.07.2020(Kërkesë për sqarim) ka kërkuar edhe sqarim shtesë në lidhje me Sigurimin e Tenderit, dhe se përgjigja e dhënë nga AK përmes e-mailit më 24.07.2020 ishte: (Komunikimi me KRPP-në nga AK-ja ka qenë përmes telefonit në formë verbale)

dok.e kërkuara

Besim Haxhija

Sent: Fri 7/24/2020 9:30 AM

To: Blerina Huruglica

Cc: Faton Gutaj

Message

Raporti i Vlersimit.pdf (7 MB)

Sigurimi i tenderit-Marisa.pdf (3 MB)

Vertetimet.....pdf (2 MB)

I/e nderuar

Po ju përcjellim dokumentet e kërkuara, dërsë sa i përket komunikimit me KRPP-në ne si Autoritet Kontraktues kemi komunikuar me telefon.

Me respekt

Eksperti Shqyrtues këtë pretendim të OE ankuesit për OE të rekomanduarin e gjene të bazuar, me faktin se Sigurimi i tenderit në ofertë është i ngarkuar komplet gabimisht për një aktivitet tjetër të prokurimit ku gjithashtu edhe nuk është i plotësuar plotësisht (mungon nënshkrimi i të sigurvearit, shuma gabim, Titulli i Aktivitetit si dhe numri i aktivitetit shih lartë faktin 2), dhe sipas nenit 59 të LPP-së dhe sipas Rruopp-së (pyetjet e shpeshta) sqarohet: citat”

Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	57
---	--	----

- Konzorciumi në fjalë iu mungojnë Referencat si dhe Procesverbalet, ata si kanë paraqitur

Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e gjene të bazuar, me faktin se në ofertën e OE të rekomanduarit ka të ngarkuara vetëm një listë të kontratave brenda tri vitet e fundit të përfunduara por nuk gjenden Referencat dhe certifikatat siç është kërkuar nga AK në FDT, e që sipas nenit 72 të LPP –së AK ka mundur të kërkojë informata shtesë.

- Ju mungojnë Punëtorët si dhe Kontratat e tyre sic është kërkuar në FDT,

Eksperti Shqyrtues gjatë verifikimit të dokumenteve të ngarkuara në ofertë të OE të rekomanduarit ka vërejtur se aty posedon vetëm listën e punëtorëve dhe se ju mungojnë kontratat (shih Faktin 1 lartë) gjersa AK ka mundur të kërkojë informata shtesë sipas nenit 72 të LPP-së, dhe se Eksperti Shqyrtues këtë pretendim të OE ankuesit e gjene të bazuar.

- Pothuajse të gjitha makineritë janë të paraqitura nga kompania Ge Group SHPK, kompani me të cilën nuk ka marrëveshje as ndonjë dokument që tregon bashkëpunim, nuk përmbushin kriterin e makinerive.

Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e gjene jo të bazuar, me faktin se konzorciumi i rekomanduar në ofertën e tij i ka të gjitha makineritë të marra me qira sipas kërkesës në FDT.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës

të anulohet, lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 27.07.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 25.07.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 05.08.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverballi mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se me qasjen tonë në dokumente të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës "Marisa SHPK&Company Murseli" kemi vërejtë se ky konzorcium nuk është i përgjegjshëm, dokumente të cilat i mungojnë konzorciumit në fjalë janë:

- Vërtetimin e ATK-së
- Certifikatën e Gjykatës Ekonomike
- Vërtetimin e Tatimit në Pronë si dhe
- Identifikimi Financiar

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se përgjigjja e AK-së për këto pretendime në kërkesën e OE ankues për rishqyrtim ka qenë :

Pretendimi juaj se:

Grupit të operatorëve ekonomik "Marisa" sh.p.k.& "Company Murseli" sh.p.k., ju mungon Vërtetimi i ATK-së, Tatimit në pronë dhe Gjykatës, nuk qëndron, sepse sepse të gjitha këto i kanë dorëzuar kopje fizike me dt.23.06.2020, kurse identifikimi financiar iu kërkohej kontraktuesin ta sjell kur të vjen për nënshkrim të kontratës;

Paneli shqyrtues sqaron se eksperti shqyrtues me datën 23.07.2020 me e-mail nga AK ka kërkuar këtë sqarim: “Ne kemi marr në shqyrtim ankesën e OE "Joos & Krasniqi” SHPK për Aktivitetin e prokurimit me nr **632-20-1308-5-2-1** at me titull " Ndërtimi I shtegut për ecje dhe ciklizëm Cabrat-Jahnoc", në ankesë janë të përfshira disa pretendime(mungojnë dokumente) të cilat ne në E-prokurim nuk po i gjejmë! Me qëllim që shqyrtimi të bëhet sa më Objektiv nga ne, ju lutem të na dërgoni këto dokumente siç keni deklaruar tek kërkesa për rishqyrtim se i keni kopje fizike:

- Vërtetimi I ATK-së
- Certifikata e Gjykatës Ekonomike
- Vërtetimi I Tatimit në Pronë

Gjithashtu ju lutem na sqaroni komunikimin me KRPP-në në lidhje me Sigurimin e Tenderit, si dhe bashka ngjiteni edhe në Attach gjithashtu”.

Autoriteti kontraktues me datën 24.07.2020 i kthen përgjigje ekspertit duke i sqaruar se këto dokumente kërkohej nga OE para nënshkrimit të kontratës dhe OE i rekomanduar i ka dorëzuar dëshmitë në fjale dhe këto dëshmi ja dërgon me email ekspertes ne attach .

Paneli shqyrtues konstaton se (Vërtetimin tatimor të ATK-së, Certifikatat e Gjykatës e Ekonomike si dhe Vërtetimin e Tatimit në Pronë, eksperti ja ka bashkangjitur edhe raportit të ekspertizës , andaj pretendimi i ankuesit në këtë pike është i pa bazuar sepse dëshmitë e kontestuar nga ankuesi, operatori ekonomik ai rekomanduar për dhëni të kontratës i ka dërguar kopjet fizike në afatin e caktuar tek AK.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës Sigurimin e tenderit e ka ofruar Gabim, ku e dimë se tek RRUOPP thuhet se nëse “Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesa e DT”-Refuzo tenderin pa kërkuar informacione të mëtutjeshme” 57.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se përgjigjja e AK-së për këtë pretendim ankimor në vendimin për kërkesën për rishqyrtim ishte :

Pretendimi juaj se:

Grupit të operatorëve ekonomik "Marisa" sh.p.k. & "Company Murseli" sh.p.k, ka pasur sigurimin e gabuar dhe për këtë arsye duhet të eliminohet, nuk qëndron, sepse ne kemi pyetur përmes telefonit në KRPP-e dhe sipas tyre, mundemi që përmes nenit 72 të LPP-së, ta kërkojmë sigurimin me të njëjten datë (05.05.2020), sepse nëse arrin të na prezantoj, atëherë do të thotë se vërtetë ka qenë gabim teknik. Me dt.17.06.2020, është kërkuar nga Grupit të operatorëve ekonomik "Marisa" sh.p.k. & "Company Murseli" sh.p.k, që të sjellë sigurimin dhe me dt 18.06.2020, i njëjti ka sjellë sigurimin të bërë me dt.05.05.2020;

Paneli shqyrtues sqaron se ekspertit Shqyrtues gjithashtu në e-mailin e dërguar me 23.07.2020 (Kërkesë për sqarim) ka kërkuar edhe sqarim shtesë në lidhje me Sigurimin e Tenderit, dhe se përgjigja e dhënë nga AK përmes e-mailit më 24.07.2020 ishte: (Komunikimi me KRPP-në nga AK-ja ka qenë përmes telefonit në formë verbale).

Andaj paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi i ankuesit për sigurimin e tenderit për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës është i pa bazuar, për faktin se Sigurimi i tenderit në ofertë është i ngarkuar komplet gabimisht, që sigurimi i tenderit ndërlidhet krejtësisht me një aktivitet tjetër të prokurimit, numër tjetër të prokurimit, ku gjithashtu edhe nuk është i plotësuar plotësisht (mungon nënshkrimi i të siguruarit, shuma është gabim. Andaj paneli shqyrtues në pajtim me nenin 39 të RRUOPP konstaton se nëse sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara, tenderi duhet të refuzohet, ashtu siç edhe përcaktohet tek neni 39 pjesa 57 të RRUOPP në të cilin thuhet:

GABIMET E TENDERIT		
Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtijshëm	57

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Konzorciumit në fjalë iu mungojnë Referencat si dhe Procesverbalet, ata si kanë paraqitur. Paneli shqyrtues konform Ekspertit Shqyrtues konstaton se ky pretendim është i bazuar, me faktin se në ofertën e OE të rekomanduarit ka të ngarkuara vetëm një listë të kontratave brenda tri vitet e fundit të përfunduara por nuk gjenden Referencat dhe certifikatat siç është kërkuar nga AK në FDT, e që sipas nenit 59 dhe 72 të LPP –së AK ka mundur të kërkojë informata shtesë.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE të rekomanduar për dhëni të kontratës i mungojnë Punëtorët si dhe Kontratat e tyre siç është kërkuar në FDT,

Paneli shqyrtues konform Ekspertit Shqyrtues konstaton se gjatë verifikimit të dokumenteve të ngarkuara në ofertë të OE të rekomanduarit është vërejtur se aty posedon vetëm listën e punëtorë dhe se ju mungojnë kontratat gjersa AK ka mundur të kërkojë informata shtesë sipas nenit 72 të LPP-së, andaj edhe ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se pothuajse të gjitha makineritë janë të paraqitura nga kompania Ge Group SHPK, kompani me të cilën nuk ka marrëveshje as ndonjë dokument që tregon bashkëpunim, nuk përmbushin kriterin e makinerive.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit Shqyrtues këtë pretendim e gjene jo të bazuar, me faktin se konzorciumi i rekomanduar për dhëni te kontratës nga AK, në ofertën e tij i ka të gjitha makineritë të marra me qira sipas kërkesës në FDT.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Gjakovë

1x1 OE -"Joos & Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.